

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 96/19 dhe 110/19), në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën **Gjuhë angleze** për klasën **VI (e gjashtë)** të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Program mësimor i shkurtuar

GJUHË ANGLEZE

për klasën VI (e gjashtë) të
arsimit fillor nëntëvjeçar

Shkup, 2020

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda **gjuha angleze** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuar me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet në mënyrë të rregullt në përputhje me plan programin e miratuar.

Me programin e shkurtuar mësimor vërtetohen temat dhe njësitë mësimore të caktuara që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, me kohëzgjatje të orës mësimore prej 30 minutave, gjatë të cilit realizohet fondi javor i parashikuar i orëve i caktuar në programin e rregullt mësimor, gjegjësisht për program mësimor me 3 orë në javë parashikohen gjithësej 96 orë me programin e shkurtuar mësimor.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar mësimor udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Shqyrtimi i temave¹

TEMA 1. BOTA IME E VOGËL: FAMILJA, SHTËPIA, SHOKËT (24 orë)

TEMA 2. BOTA IME E JASHTME: SHKOLLA, INTERESAT/ HOBI, AKTIVITETE TË LIRA (24 orë)

TEMA 3. LAGJJA JONË, QYTETI JONË, BOTA JONË (24 orë)

TEMA 4. PLANETI YNË, SHËNDETI YNË, E ARRDHMJA JONË (24 orë)

Duke marrë parasysh fondin e plotë të orëve të parashikuar me programin e shkurtuar mësimor, rekomandohet qasje holistike gjatë të mësuarit të gjuhës në kornizat e nocioneve/temave të dhëna të cilët përfshijnë forma të ndryshme të orëve që përfshijnë jo vetëm përvetësim të fjalorit dhe formave gramatikore por edhe funksionet të paraparë gjuhsore, të cilët në mënyrë reciproke do të kontribuojnë në të mësuarin efektiv të aftësive gjuhësore (të dëgjuarit dhe të lexuarit me të kuptuar, të folurit dhe të shkruarit) dhe do të mundësojnë zhvillim të plotë të kompetencave komunikuese të nxënësve.

Gjatë kësaj, rekomandohet prezantim kualitativ të përmbajtjeve të reja mësimore me implementim të aktiviteteve të paraparë për përfundimin e të njëjtive.

¹ Në lidhje me nocionet e dhëna si dhe numrit të orëve të ofruar për të njëjtët, arsimtari/arsimtarja vlerëson për mënyrën dhe gjanësinë gjatë përfundimit të çdo teme një nga një, duke marrë parasysh qasjen e integruar dhe balancuar gjatë të mësuarit të çdo elementi gjuhësor, në përputhje me mundësitë e nxënësve dhe nevojat e tyre.

Multikulturalizmi, përmbajtjet interkulturore dhe shkrim leximi medial janë pjesë të pashkëputur të mësimi në gjuhën angleze si gjuhë e huaj. Përfshirja e tyre në tepricën e përmbajtjeve mësimore mundëson realizimin e tyre në mënyrë konkrete dhe zbatimin praktik të njohurive dhe aftësive të fituara gjatë mënyrës të komunikimit bashkëkohor si dhe stilit e të jetuarit.

3. Rekomandime didaktike

Pikënisja në realizimin e programit të shkurtuar mësimor në lëndën **gjuhë angleze** është programi i rregullt mësimor (rezultate nga të mësuarit, përmbajtje dhe nocione, aktivitetet dhe metodat e propozuara, si dhe standardet për notim)

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar mësimor, mësimi në gjuhën angleze si gjuhë e huaj realizohet përmes qasjes të integruar pa bërë ndarje të komponentave të veçanta gjuhësore apo aftësive sipas numrit të orëve të planifikuar. Është me rëndësi të përmendet se të mësuarit e gjuhës angleze nuk bazohet në të mësuarit veçmas të elementeve gjuhësore, si fjalori, gramatika dhe funksionet gjuhësore, por është i nevojshëm të mësuarit të balansuar dhe integruar të këtyre elementeve në kontekst. Veçanërisht gramatika nuk duhet të mësohet me të mbajturit mend të rregullave apo definicioneve për përdorim, por në mënyrë kontekstuale (me shembuj), që të kuptohet rëndësija dhe zbatimi i tij autentik në gjuhë.

Qëllimet e programit mësimor për klasën e pgjashtë janë pjesë e qëllimeve të parashikuar në ciklin e dytë e të mësimit të gjuhës së huaj (klasa e IV – VI) në të cilin parashikohet që nxënësit ta arrijnë nivelin fillestar A1 e të zotëruarit të gjuhës duke përparuar dalë ngadalë me rritje graduale të fondit të fjalëve, llojit të funksioneve gjuhësore si dhe ndërlikueshmërinë e formave gramatikore. Kjo do të thotë se vëmendje të njëjtë u kushtohen aftësive gjuhësore si në nivelin receptiv ashtu dhe në atë produktiv, si: të dëgjuarit me të kuptuar, të lexuarit me të kuptuar, të folurit (ndërveprim gojor dhe produkim) dhe të shkruarit (ndërveprim me shkrim dhe produkim me shkrim), me qëllim që të nxitet zhvillimi i integruar i kompetencave komunikuese.

Mësimi në gjuhën angleze për nxënësit e kësaj moshe mbështetet në të mësuarit multisenzorik (vizual, auditiv, taktil, etj.) dhe holistik e cila i përkap aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, gjegjësisht arsimitari i integron komponentat e ndryshme me se gjuha mësohet në mënyrë funksionale.

Gjatë zgjedhjes të aktiviteteve duhet patur kujdes në ndryshimin dhe shumllojshmërinë e tyre, gjatë të cilit duhet të zgjidhen aktivitete të cilat janë të përshtatshme me moshën kronologjike të nxënësve, si dhe zhvillimin e tyre kognitiv, gjegjësisht aktivitete me të cilat do të tërhiqet vëmendja e nxënësve.

4. Normativ për kuadër mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhëtur në programin për mësim të rregullt.

Programin e shkurtuar mësimor në lëndën **gjuha angleze** për klasën e **gjashtë** të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi,

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
